

Shofer/Sektor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik" i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, dt. 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike, urdhrit të Kryeministrit nr. 32, datë 16.03.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Shofer/Sektor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Siguron transportin e punonjësve të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, për nevoja të punës;
- Administron dhe përgjigjet për mbajtjen e automjetit në gjendje funksionale;
- Merr në dorëzim automjetin me dokumentacionin përkatës dhe kujdeset për mirëmbajtjen e tij;
- Respekton destinacionin e lëvizjes së autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK;
- Plotëson fletë-udhëtimet, të firmosura bashkë me personat udhëtues dhe i dorëzon ato periodikisht;
- Kujdeset për cilësinë e punës, kur automjeti ndodhet në shërbime-riparime;
- Ndjek dhe zbaton me rigozitet rregullat e qarkullimit rrugor;
- Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar, me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDITËT

Arsimi: Niveli minimal diplomës, arsim i mesëm.

Përvoja: Të ketë të paktën 10 vite i pajisur me leje drejtimi të klasit B.

- Aftësi të mira komunikuese;
- Të mos jetë i dënuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (III)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 15.10.2023, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV;
- Fotokopje të diplomës;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Vërtetim nga gjykata;
- Raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell shkualifikim të kandidatit.